



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 615, Datë 02.05.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.05.2019 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2; 10; 12, neni 24, germa d; dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë të LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.

VËREN SE :

Procedura dhe transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të

shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.

Blerësi: Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft (Volkswagen Financial Services AG), është një shoqëri aksionare e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Braunschweig. Shoqëria është pjesë e Grupit Volkswagen, i cili drejtohet nga ndërmarrja mëmë fundore e grupit Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG).

Volkswagen AG, shoqëri aksionare, është regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Braunschweig-ut.

Grupi Volkswagen ka tre entitete të themeluara në Shqipëri: Porsche Leasing SHPK, Porsche Mobility SHPK, Porsche Albania SHPK.

Porsche Albania SHPK, shoqëri me objekt të aktivitetit shitje me shumicë dhe pakicë të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, kryerjen e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve etj. Ortak me 100% të kuotave është Porsche Holding Gesellschaft m.b.H.

Porsche Leasing SHPK, shoqëri me objekte të aktivitetit veprimtari të qirasë financiare, agjent në sigurime. Ortakë i kësaj shoqërie është Porsche Bank Aktiengesellschaft me 100% të kuotave.

Porsche Mobility SHPK, shoqëri me objekt të aktivitetit çdo formë e aktivitetit, veprimtarisë së qirasë operacionale siç parashikohet nga dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Civil. Ortakë me 100% të kuotave është Porsche Bank Aktiengesellschaft.

Shitësi: DVB Bank SE është një shoqëri e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Frankfurtit am Main.

Targeti: LogPay Financial Services GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, dhe e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Frankfurtit am Main.

Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni është një përfitim kontrolli i shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar; Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit është lënë i hapur dhe tregu përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të LogPay Financial Services GmbH nga Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.

Shoqëria Target LogPay Financial Services GmbH së bashku me shoqëritë në zotërim të saj nuk operojnë në Shqipëri.

Volkswagen AG operon në Shqipëri nëpërmjet Porsche Albania SHPK, Porsche Leasing SHPK dhe Porsche Mobility SHPK. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS